




# Ritregimi i Historisë



Shkup, 2007

---

Materiali të cilin e keni para jush paraqet rezultat të projektit të titulluar si **Ritregimi i Historisë**.

Projekti paraqet përpjekje të përbashkët të AMHM (Asociacioni i Mëesuesve të Historisë të Maqedonisë) dhe EUROCLIO (Shoqatës së Mësuesve të Historisë të Evropës). I njëjtë finansiarisht është përkrahur nga USIP (United States Institute of Peace) ndërsa si konsulentë dhe ekspertë të jashtëm në projekt marrin pjesë dr. Dean Smart, University of West England, prof. dr. Keith Barton, University of Cincinnati dhe Joke van der Leeuw-Rord, drejtor ekzekutiv i EUROCLIO.

Ekipin e projektit e përbënë 11 historianë nga Maqedonia nga profile të ndryshme, mësues nga arsimi fillor dhe i mesém, si edhe punëtorë shkencorë. Ata para vetes e vendosën detyrën të përpunojnë program alternativ për histori, por edhe shembull të përpunimit të përbajtjeve mësimore në tekstet mësimore mbi bazën e programit të përmendur.

Qëllimi i projektit është që të tregoj nevojën e përfshirjes së inovacioneve, por para së gjithash në qasjen ndaj mësimit të historisë. Duke i pasur parasysh të gjithë përbërësit e një të mësuari bashkëkohor dhe pa ngarkesa ideologjike, u nis nga vet fillimi, respektivisht me krijim të programit alternativ. Në këtë rast ekipi u vendos pér përpunimin e periudhës – Maqedonia në shek. XX. Me programin alternativ trajtohet edhe periudha e historisë më të re të Maqedonisë, posaçërisht periudha 1999-2000, duke e pasur në mendje se me programet e gjertanishme i njëjti thuajse aspak nuk përpunohet.

Pastaj u kalua në përpunimin e disa përbajtjeve mësimore të cilat duhet të shërbejnë si shembull për qasje të paanshme dhe pa përkrahje ndaj trajtimit të ngjarjeve historike.

Duke menduar se programet aktuale të historisë janë të ngarkuara me politikë dhe histori luftarakë, në programin alternativ rëndësi më të madhe u është dhënë aspektit social dhe kulturor, e posaçërisht jetës së përditshme të njeriut të thjeshtë.

Njëkohësisht programi sugjeron dhe motivon aspekte të ndryshme të mësimit, siç janë zhvillimi i shkakhtësive historike, të menduarit kritik, ndërtimi i qëndrimeve personale, qasja me shumë perspektiva dhe të ngjashme. Gjatë kësaj, kujdes të veçantë i kushtohet promovimit të punës me burime historike.

Qëllimi i projektit nuk është të jep një zgjidhje të përsosur për përparimin mësimit të historisë, por të hap disa vizione të reja, të cilat do t'u ndihmojnë krijuesve të programeve mësimore, por edhe autorëve të teksteve mësimore në përshtatjen ndaj proceseve në mësimin e historisë të cilat jo shumë kohë më parë janë bërë pjesë e realitetit në pjesën më të madhe të vendeve evropiane.

Parimi i punës i cili promovohet me qasjen e këtillë ndaj mësimit bazohet në disa elemente: perspektiva të shumta, puna me burime, të menduarit kritik, por edhe trajtimi i çështjeve të diskutueshme dhe të ndjeshme. Ata do të duhet të formojnë nxënës të cilët të pavarur hulumtojnë, mendojnë dhe sjellin përfundime të tyre.

Njëkohësisht pritet që projekti do të jap kontributin e vet në tejkalimin e ndarjes etnike, duke e pasur në mendje qasjen shumetnikë, tolerancën dhe vetëdijen pér të përbashkëtën të cilat promovohen me të.

---

periudha historike	MAQEDONIA NË SHEK. XX
temat	përbajtja
<b>LUFTA E PARË BOTËRORE</b> <i>Cili ishte ndikimi i Luftës së Parë Botërore ndaj popullatës?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Veprimet luftarake</li> <li>• Emigracioni dhe lëvizjet politike</li> <li>• Jeta e përditshme gjatë kohës së luftës</li> <li>• Pasojat nga lufta</li> </ul>
<b>MBRETËRIA SKS</b> <i>Si dukej të jetohet ndërmjet dy luftërave botërore?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Jeta politike</li> <li>• Jeta e përditshme</li> <li>• Arsimi dhe kultura</li> </ul>
<b>LUFTA E DYTË BOTËRORE</b> <i>Cila është rëndësia e Luftës së Dytë Botërore për Maqedoninë?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Okupimi dhe ndarja e Maqedonisë</li> <li>• Rezistenca</li> <li>• Krijimi i shtetit Maqedonas</li> <li>• Jeta e përditshme gjatë kohës së luftës</li> </ul>
<b>JUGOSLLAVIA FEDERATIVE</b> <i>Si dukejjeta në federatën jugosllave?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet politike dhe ekonomike</li> <li>• Modernizimi, industrializimi dhe transporti</li> <li>• Jeta sociale</li> <li>• Ideologjia</li> <li>• Arsimimi</li> <li>• Kultura masive</li> <li>• Proceset liberale dhe demokratike</li> <li>• Pozita e gruas</li> <li>• Shkatërrimi i Jugosllavisë</li> </ul>
<b>MAQEDONIA E PAVARUR</b> <i>Si e ndryshuan jetën në Maqedoni vitet e 90-ta?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Skenë e re politike</li> <li>• Marrëdhëniet ndëretnikë</li> <li>• Tranzicioni</li> <li>• Jeta e përditshme</li> </ul>

<b>temat përbajtja</b>	MAQEDONIA E PAVARUR 1990-2000 <b>SKENË E RE POLITIKE</b>
<b>Pyetja kyçë</b>	Cilat ndryshime ndodhën në planin politik në Maqedoni?
<b>Përbajtja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga sistemi njëpartiak në sistemin shumëpartiak</li> <li>• Procesi i pavarësimit</li> <li>• Zhvillimi i demokracisë</li> <li>• Pozita ndërkombëtare</li> </ul>
<b>Shkathësi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analizë</li> <li>• Mendim kritik</li> <li>• Krahasim</li> <li>• Mbrojtja e qëndrimeve</li> </ul>
<b>Koncepti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet dhe përfitimet</li> <li>• Shpresat dhe dëshpërimet</li> </ul>
<b>Dituri</b> <i>Çka duhet nxënësit të dijnë?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pluralizmi, ndarjet partiake</li> <li>• Procesi i pavarësimit</li> <li>• Pozita ndërkombëtare e Maqedonisë</li> </ul>
<b>Aktivitete</b>	<p><b>A (hyrëse)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tetëkahëshi</li> <li>• Sqaruesi i fjalëve</li> </ul> <p><b>B (kryesore)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza dhe sinteza e dokumenteve</li> <li>• Luajtja e rolit</li> <li>• Ndjeshmëria</li> <li>• Përpunimi i logos, parullës dhe programit</li> </ul>
<b>Rezultati</b> <i>Si e dimë se nxënësit kanë mësuar</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund t'i sqarojnë dhe përdorin shprehjet e reja</li> <li>• E kuptojnë procesin e pranimit ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë</li> <li>• Munden në mënyrë kronologjike t'i renditin ngjarjet</li> <li>• Bëjnë krahasim ndërmjet sistemeve njëpartiake dhe atyre shumëpartiake</li> <li>• E njojin arsyen për krijimin e partive mbi bazën etnike</li> </ul>

<b>temat përbajtja</b>	<b>MAQEDONIA E PAVARUR 1990-2000 MARRËDHËNIET NDËRETNIKE</b>
<b>Pyetja kyçë</b>	Si zhvillohen marrëdhëniet ndëretnike?
<b>Përbajtja</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkësítë etnike në Maqedoni</li> <li>• Aktet ligjore dhe dispozitat</li> <li>• Institucionet e sistemit dhe bashkësítë etnike</li> <li>• Bashkëjetesa – realitet ose trillim</li> </ul>
<b>Shkathtësi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndërtimi i qëndrimit</li> <li>• Mbrojtja e qëndrimit</li> <li>• Analizë</li> <li>• Krahasim</li> <li>• Ndjeshmëri</li> </ul>
<b>Koncepti</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet dhe vazhdimësia</li> <li>• Arsyet dhe pasojat</li> <li>• Respektimi i dallimeve</li> </ul>
<b>Dituri</b> <i>Çka duhet nxënësit të dijnë?</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• T'i kuptojnë shprehjet shoqëri multikulturore, stereotip, paragjykime, tolerancë...</li> <li>• T'i njojin të drejtat dhe detyrat e bashkësive etnike</li> <li>• Të njihen me aktet ligjore dhe me normat</li> <li>• Të dinë për ndikimin e politikës ndaj marrëdhënieve ndëretnike</li> <li>• Të dinë për përparësitë e shoqërisë multikulturore</li> </ul>
<b>Aktivitete</b>	<p><b>A (hyrëse)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mbush tabelë të regjistrimit</li> <li>• Çka mendojnë njerëzit për...</li> </ul> <p><b>B (kryesore)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Dramatizim me debat: “Mëhallë jonë”</li> <li>• Analizë dhe sintezë e dokumenteve</li> <li>• Dritare me tre kanatë (si është tani, si do të jetë, si dua të jetë)</li> </ul>
<b>Rezultati</b> <i>Si e dimë se nxënësit kanë mësuar</i>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mund të tregojnë karakteristika etnike</li> <li>• Janë tolerantë dhe zhvillojnë respekt ndaj dallimeve</li> <li>• Janë të vetëdijshëm për dëmin nga marrëdhëniet e prishura ndëretnike</li> <li>• Tregojnë ngjarje të rëndësishme për marrëdhëniet ndëretnike</li> </ul>

<p><b>temat përmbajtja</b></p>	<p><b>MAQEDONIA E PAVARUR 1990-2000</b></p> <p><b>JETA E PËRDITSHME</b></p>
<p><b>Pyetja kyçë</b></p>	Në cilën mënyrë ndryshimet në shoqëri ndikojnë ndaj jetës së përditshme?
<p><b>Përmbajtja</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Familja</li> <li>•Arsimi</li> <li>•Kultura masive</li> <li>•Urbane-rurale</li> </ul>
<p><b>Shkathësi</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Komunikimi dhe të shprehurit</li> <li>•Krahasimi dhe vlerësimi</li> <li>•Vështrimi i fakteve dhe ndërtimi i qëndrimeve (vështrimeve)</li> </ul>
<p><b>Koncepti</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•Vazhdimësi dhe ndryshime</li> <li>•Ngjashmëri dhe dallime</li> </ul>
<p><b>Dituri</b> <i>Çka duhet nxënësit të dijnë?</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•T'i vërejnë ndryshimet në familje</li> <li>•T'i vërejnë ndryshimet në sistemin arsimor</li> <li>•Të dinë për lëvizjet migruese</li> <li>•Ta vlerësojnë rolin e kulturës masive në jetën e përditshme</li> <li>•T'i vërejnë vlerat e traditës, zakoneve dhe religionit</li> </ul>
<p><b>Aktivitete</b></p>	<p><b>A (hyrëse)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Diagrami i Venit</li> <li>•Shpinë për shpine</li> <li>•Të shprehurit kreativ (shtëpia ime)</li> </ul> <p><b>B (kryesore)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>•Puna me burime</li> <li>•Intervistë dhe anketë</li> <li>•Debat</li> </ul>
<p><b>Rezultati</b> <i>Si e dimë se nxënësit kanë mësuar</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>•E vërejnë rolin e familjes në shoqëri</li> <li>•Kanë qëndrim kritik ndaj kulturës masive</li> <li>•Vërejnë ngjashmëri dhe dallime</li> </ul>

<p><b>temat</b></p> <p><b>përbajtja</b></p>	<p><b>MAQEDONIA E PAVARUR 1990-2000</b></p> <p><b>TRANZICIONI</b></p>
<p><b>Pyetja kyçë</b></p> <p><b>Përbajtja</b></p>	<p>Cilat janë pasojat nga tranzicioni në shoqëri?</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Privatizimi</li> <li>• Mediat masive</li> <li>• Organizatat joqeveritare</li> <li>• Denacionalizimi</li> <li>• Aferat financiare</li> <li>• Anomalitë e tranzacionit</li> </ul>
<p><b>Shkathësi</b></p> <p><b>Koncepti</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tërheqja e informatave</li> <li>• Verifikimi i arsyeve dhe pasojave</li> <li>• Ndërtimi dhe mbrojtja e qëndrimeve</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet dhe përfitimet</li> <li>• Shpresat dhe përfitimet</li> <li>• Përparim dhe ngecje</li> </ul>
<p><b>Dituri</b></p> <p><i>Çka duhet nxënësit të dijnë?</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tranzicioni si koncept dhe proces</li> <li>• Ta vërejnë ndikimin e mediave</li> <li>• Ta kuptojnë rolin e OJQ</li> <li>• Ta kuptojnë procesin e privatizimit dhe denacionalizimit</li> </ul>
<p><b>Aktivitete</b></p> <p><b>Rezultati</b></p> <p><i>Si e dimë se nxënësit kanë mësuar</i></p>	<p><b>A (hyrëse)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Stuhia e mendimeve</li> <li>• Ulësja e nxehthë</li> </ul> <p><b>B (kryesore)</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza dhe sinteza e dokumenteve</li> <li>• T-Tabela dhe diagrami i Venit</li> <li>• Intervistë</li> <li>• Hulumtim</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I kuptojnë dhe i përdorin në formë përkatëse shprehjet dhe termat e posa mësuara</li> <li>• I kuptojnë proceset e privatizimit dhe denacionalizimit</li> <li>• I kuptojë lidhjet mes arsyeve dhe pasojave të cilat sollën gjer te aferat financiare</li> <li>• E vërejnë rolin e mediave masive dhe organizatat joqeveritare</li> <li>• E vërejnë rolin e politikës në tranzicion</li> </ul>


# SKENË E RE POLITIKE

Në nënëtor të vitit 1990 u mbajtën zgjedhjet parlamentare në të cilat qytetarët e Republikës së Maqedonisë për herë të parë kishin mundësi të zgjedhin përfaqësues nga më tepër parti politike dhe kandidatë të pavarur. Në janar të vitit 1991 u formua kuvendi i parë shumëpartiak, ndërsa më 25 janar 1991 u miratua Deklarata për Sovranitet të R.S. të Maqedonisë. Kah fundi i muajit me vota të fshehta deputetët si president të parë të Republikës së Maqedonisë e zgjodhën z. Kiro Gligorovin.

Më 20 mars 1991 u formua edhe e ashtuquajtura qeveria e parë e eks-pertëve e udhëhequr nga akademik prof. dr. Nikola Klusev. Menjëherë pas formimit qeveria e re ndërmori aktivitete për ndryshime në jetën ekonomike dhe në sistemin politik, si edhe pavarësim monetar dhe ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë.



Qeveria e parë e R. së Maqedonisë



Udhëheqës të partive politike, 1990.

## Vendosja e sistemit shumëpartiak

**1** Me miratimin e amendamenteve dhe plotësimit të ligjit ekzistues, organizatat publike dhe asociacionet qytetare, sistemi politik shumëpartiak i cili ishte më realitet në Maqedoni, tani bëhet legjislaturre praktike. Mund të themelohen asociacione me së paku 10 njerëz me moshë mbi 18 vjeçare, anëtarët e të cilëve kanë qëndrim të përhershëm në Maqedoni, dhe çdo person tjetër mund të jetë anëtar nëse ka mbushur formular dhe të drejtat qytetare të të cilit nuk janë të shkelura ose të kufizuara me urdhëresë të gjyqit.

*Nova Makedonija, 13.04.1990*

**2** Jemi të lumtur ne-votuesit të cilët e arritën periudhën parazgjedhore. Ne ishim të lënë anash dhe na gjenjen, por tani për herë të parë në 50 vite, bëhem pjesëmarrës në lojë politike, lojtarët e së cilës vet e përcaktojnë rezultatin. O bukuri, o bukuri e pluralizmit! (...) Në fakt në vendin tim këtyre ditëve, ajri është i mbushur me aromën e demokracisë. Nuk ka parti politike pa fjalën demokratët në emrin e saj ose në programin e saj. (...) Problemi është se disa nga ata të cilët me tërë zemrën deklarojnë se partia e tyre e ndihmon demokracinë, në jetën politike, kulturore dhe publike bën çdo gjë ta shtyp demokracinë e njëjtë në ditët kur demokracia është e nevojshme më shumë se çdo gjë tjetër, edhe atë në kohën kur aroma e luleve të vetme komuniste depërtion gjithkund nga kopshti komunist.

*Tomislav Osmanli, Në çastin e vdekjes, 1993*

## 3

### Kushtetuta e vitit 1991

*Neni 20*

Qytetarëve u garantohet liria e bashkimit dhe mbrojtja e të drejtave dhe lirive politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe të tjera.

Qytetarët mund lirisht të themelojnë shoqata të qytetarëve dhe parti politike, t'u bashkëngjiten apo të tërhiqen nga to...

*Neni 22*

Secili qytetar kur do të mbushë 18 vite moshë, e fiton të drejtën e votës. E drejta e votimit është e barabartë, universale dhe e drejtëpërdrejtë, dhe zbatohet në zgjedhjet e lira me votim të fshehtë.

## 4

### Deklarata për sovranitet të R. S. të Maqedonisë

Kjo deklaratë e shpreh sovranitetin e Republikës Socialiste të Maqedonisë në pajtueshmëri me vendimet konstitutive për pavarësi dhe integritet tokësor të shtetit maqedonas dhe të drejtën e popullit maqedonas për vetëpërcaktim, duke e përfshirë edhe të drejtën e shkëputjes.

*Gazeta zyrtare e R. S. të Maqedonisë, 01.02.1991*

## 5

### Referendumi

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, vendosi që me 6 gusht 1991 të mbaj referendum dhe ta vërtetoj pyetjen që duhet të parashtronet në referendum: *A jeni për Maqedoni të pavarur me mundësi për hyrje në lidhje me shtetet tjera të Jugosllavisë?*

*Monografia, Republika e Maqedonisë, 1999*



71,85% pjesëmarrje në referendum



Nga numri i përgjithshëm i votuesve, pozitivisht janë shprehur 95,05%



## Cilat ndryshime ndodhën në Maqedoni në planin politik?

Njëri nga aktivitetet më të rëndësishme të kuvendit ishte vendimi për shpalljen e referendumit për pavarsim të Republikës së Maqedonisë, i cili u mbajt më 08.09.1991. I njëjtë nuk u përkrah nga elektorati shqiptar. Pas mbajtjes së referendumit kuvendi e miratoi deklaratën për pavarsi dhe sovranitet të Republikës së Maqedonisë. Procesi i pavarsimit u rrumbullakua me miratimin e kushtetutës nga ana depitetëve më 17.11.1991, edhe pse përfaqësuesit shqiptarë në shtëpinë ligjdhënëse nuk e përkrahën të njëjtin.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes ndërmjet presidentit Kiro Gligorov dhe përfaqësuesit të APJ-së (Armata Popullore Jugosllave) Blagoja Axhiq, filloi tërheqja e APJ-së nga territori i Republikës së Maqedonisë. Njëkohësisht zhvillohej edhe procesi i krijimit të ARM-së (Armatës së Republikës së Maqedonisë).

Në vitin 1994 u mbajtën zgjedhjet e dyta parlamentare dhe zgjedhjet e dyta presidenciale. Në këtë zgjedhje si kryetar në zgjedhje të drejtpërdrejta të qytetarëve



Sheshi në Shkup pas shpalljes së rezultateve nga Referendum.



Nënshkrimi i marrëveshjes për largim të qetë të APJ-së nga Maqedonia

**6**

### PAVARËSIA

Atë natë, ashtu siç burrështetasit tanë dhe udhëheqësit partiakë pinin shampanjë festive në skenën në sheshin e qytetit, dikush nga masa e popullit, seriozisht apo me shaka tha: "Kujdes-do të deheni nga shamanja! Ndërsa barku i uritur flet më shumë se ai!"

*Revista Svet, nr.63, 1996*

**7**

### Sa jemi sovranë?

U deklaruam për sovranitetin e Republikës së Maqedonisë. U deklaruam para gjithë botës demokratike dhe paqedashëse, të cilët kanë pasur mundësi ta shohin video lentën e atij nazi përbindëshi, të hipur në atë "automjet luftarak", e cila pa asgjë njerëzore në vete e mybyti ushtarët maqedonas. Por, çfarë lloj sovraniteti është ai, kur ushtarët tanë vdesin në fushëbetejet e dikujt? Çfarë lloj sovraniteti është ai, kur nuk mund vetë ne t'i rekrutojmë ushtarët tanë? Çfarë lloj sovraniteti është ai, kur djemtë tanë i zgjojnë nga krevati dhe i çojnë... kushedi se ku (...)? Cilat janë fshehtësítë e një lufte kur prindi nuk e din se ku e çojnë fëmijën e tij? Dikush do të thotë "gjendje lufte, mobilizim"... pse ata nuk i mobilizojnë fëmijët e atyre të cilët na sollën deri te kjo "luftë ndër vëllazërore", dhe kur "vaji i vdekjes" do të vij në shtëpitë e tyre, atëherë mund të vijnë deri te vetëdija e tyre e shëndoshë.

*Nova Makedonija, 14.05.1991*

**8**

### Karvani i nënave maqedonase

Nuk qajmë për atë se djemtë na janë ushtarë, por nuk duam të vdesin për çmenduri të huaja-porositën prindërit të cilët së pari u mblodhën në parkun Gruaja Luftëtare, dhe pastaj hyrën në Kuvendin e Maqedonisë. Këshilli organizativ parashtroi më shumë kërkesa, ushtarët maqedonas nga Zona e Pestë Ushtarakë menjëherë të kthehen të kryejnë shërbimin ushtarak në Maqedoni: qeveria e Sllovenisë ti ndërpresë të gjitha veprimet luftarakë dhe t'i garantojë jetët e fëmijëve të tyre, të sigurohen kushte për jetën e ushtarëve derisa të kthehen (ushqim, ujë), të sigurohen paraqitje telefonike, Kryqi i Kuq i Maqedonisë të organizojë vizitë të ushtarëve nga ana e prindërvë të tyre.

Mbi 400 prindër të ushtarëve nga Maqedonia të cilët janë në kryerje të shërbimit ushtarak në Zonën e Pestë Ushtarakë, mbrëmë rreth orës 10 u mblodhën në parkun Gruaja Luftëtare që ta shprehin revoltin e tyre dhe brengosjen përfatim e fëmijëve të tyre. Të organizuar arriën 60 prindër nga Strumica, të cilët bashkë me këta këto nga Shkupi, Dibra, Radovishi dhe vendet tjera nga Republika kërkuan pranim në Parlamentin e Maqedonisë. Pas prites dyorëshe i pranoi kryetari i Kuvendit Stojan Andov. Në bisedën që zgjati katër orë, të ngjeshur me emociione, të shoqëruar me lot dhe në momente revoltues, mori pjesë edhe ministri i mbrojtjes popullore të Maqedonisë, Risto Damjanovski.

*Gazeta e përditshme, Vecer, 05.07.1991*



Qindra nëna protestojnë në Parlamentin e Maqedonisë

u zgjodh Kiro Gligorov, ndaj të cilit më vonë në vitin 1995 u krye atentat nga ana e kryerësve të panjohur. Zgjedhjet e treta parlamentare u mbajtën në vitin 1998, ndërsa në vitin e ardhshëm edhe zgjedhjet presidenciale. Nga gjashtë kandidatët që morën pjesë në zgjedhje, si kryetar u zgjodh Boris Trajkovski.

Pas pavarësimit udhëheqësit maqedonas ndërmorën aktivitete për pranim ndërkombetar. Komisioni i Badenterit në janar 1992 dha mendim pozitiv se R. M. i plotëson kushtet për pranim ndërkombetar, por këshilli i ministrave i B. E. (Bashkimit Evropian) në Lisbonë lajmëroi se pranimi i Maqedonisë shtyhet deri në zgjidhjen e kontestit me emrin. Edhe krahas problemeve me emrin një pjesë e shteteve nga Ballkani dhe më gjërë e pranuan R. e Maqedonisë me emrin kushtetues. Ndërshtetet e para ishin Bullgaria, Turqia, Sllovenia, Kroacia dhe Bosnja dhe Hercegovina.

Pranimi ndërkombetar i Republikës së Maqedonisë u rrumbullakua me pranimin në K.B. (Kombet e Bashkuara), me referencën IRJM (Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë), ndërsa si



**Kiro Gligorov**  
(kryetar i R. M.-së 1991-1999)



**Boris Trajkovski**  
(kryetar i R. M.-së 1999-2004)

## 9 REZULTATE NGA ZGJEDHJET PARLAMENTARE

Partia	Viti i zgjedhjeve		
	1990	1994	1998
Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas	38	/	49
Lidhja Social-Demokrate e Maqedonisë	31	59	27
Partia për Prosperitet Demokratik	22	10	14
Partia Liberale	18	29	/
Partia Socialiste	4	7	1
Partia e Jugosllavëve	2	/	/
Partia Popullore e Shqiptarëve	1	/	/
Partia për Emancipim të Tërësishëm të Romëve	1	1	/
Kandidatë të Pavarur	3	7	/
Partia Demokratike Popullore	/	4	/
Partia Demokratike e Maqedonisë	/	1	/
Partia Social-demokratike	/	1	/
Partia Demokratike Turke	/	1	/
Alternativa Demokratike	/	/	13
Partia Demokratike Shqiptare	/	/	11
Partia Liberale Demokratike	/	/	4
Lidhja e Romëve të Maqedonisë	/	/	1

**10 Komisioni i Badenterit**  
Sipas Komisionit Arbitrar të Bashkësisë Evropiane (Komisioni i Badenterit) më 11 janar 1992: *Republika e Maqedonisë i plotësoi kushtet të cilat u parashtruan nga direktivat për Pranim të Shteteve të Reja në Evropën Lindore dhe në Bashkimin Sovjetik si edhe me Deklaratën e Jugosllavisë të miratuar nga këshilli i ministrave të Bashkësisë Evropiane më 16 dhjetor 1991.*

[www.historyofmacedonia.org](http://www.historyofmacedonia.org)

## 11 Deklarata e Micotakisit rreth pyetjes me cilat kushte do ta pranonin R.M. si shtet të pavarur

Nëse në Shkup mbisundon mendimi se duhet të shpallet Republikë e pavarur, patjetër të jetë e qartë se përvetësimi i emrit grek, me të cilin shikuar historikisht populli i cili jeton në "Republikën e Shkupit" nuk ka asnjë lidhje, respektivisht përfshinë pretendime territoriale.

*Nova Makedonija 15.01.1992*

**12 Deklarata e Lisabonit**  
...theksojnë se janë të përgatitur ta pranojnë kërkesën e Maqedonisë të pranohet si shtet i pavarur në kufijtë ekzistues. B.E. është e përgatitur atë ta bëjë në atë moment kur do të zgjidhet problemi i emrit të asaj Ish Republike Jugosllave.

*Nova Makedonija, 28.06.1992*


rezultat i shtypjes nga Republika e Greqisë. Pas pranimit në K.B., 08.04.1993, Republika e Maqedonisë bëhet anëtare edhe e shumë institucioneve ndërkombëtare, asociacioneve dhe bashkësive.

Bullgaria e para e pranoi shtetin maqedonas në janar 1992 me emrin kushtetues, por në të njëjtën kohë nuk e pranoi kombin maqedonas dhe gjuhën maqedonase.

Greqia në vjeshtë të vitit 1992 vendosi bllokadë ekonomike ndaj Maqedonisë, ndërsa marrëdhëniet u normalizuan me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përkozhshme në shtator të vitit 1995.

R.S. e Jugosllavisë refuzoi t'i normalizojë marrëdhëniet dhe të vendosë çfarëdo qoftë marrëdhënie diplomatike, deri në shtator të vitit 1996 kur e pranoi me emrin kushtetues.

Shqipëria e pranoi Maqedoninë me emrin kushtetues në vitin 1993.



**Branko Crvenkovski**  
(kryeministër i R. M.-së 1991-1999)



**Lulzim Basha**  
(kryeministër i R. M.-së 1998-2002)

**13** Ndërmjetësuesi i SHBA-s, Riçard Hollbruk arri i marrëveshje ndërmjet dy shteteve më 13 shtator 1995. Maqedonia u pajtua ta ndrysho flamurin e saj dhe të përfshijë dispozita në kushtetutën e saj me çka pengohet të bëjë çfarëdo qoftë pretendime territoriale ndaj vendeve fqinje. Greqia u pajtua ta tërheqë bllokadën tregtare dhe ndalesën për njerëzit me pasaportë maqedonase dhe të ndalet ta pengojë ndihmën nga Unioni Evropian për Maqedoninë.

*Nova Makedonija, 14.09.1995*

**14** Pjesë nga fjalimi i Kiro Gligorovit me rastin e pranimit në KB

...pranimi i RM-së në familjen ndërkombëtare të popujve është akt me të cilin triumfon drejtësia dhe shembull i ndritur se si një popull i vogël dhe paqedashës me rrugë paqësore dhe legitime e realizoi të drejtën e tij për vetëpërcaktim dhe shtetësi dhe përgjegjësinë e vetë me bashkësinë ndërkombëtare... me këtë akt u kurorëzua synimi shumëshekullor i popullit maqedonas dhe luftën së tij 130 vjeçare për pavarësi dhe liri...

**15** Deklarata e Tadeush Mazovjeckit

(raportues i veçantë i OKB-së për ish Jugosllavinë)

Publiku ndërkombëtar ka borxh të madh për të kthyer ndaj Maqedonisë. Atij shteti i është shkaktuar padrejtësi e madhe me kryerjen e shtypjes ndaj saj, në momentet kur ajo arriti pavarësi, të pranojë emër absurd – Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.


*Utrinski Vesnik, 29.03.2004*



1992 - 1995



1995 -



1. Cilat shpresa dhe zhgënjime i përmend autor? (dok. 2)
2. Si do ta kishe parashtruar ti pyetjen e referendumit?
3. Pse edhe përkrah shpalljes së sovranitetit, ushtarët maqedonas ishin të rekrutuar në APJ? (dok. 4, 7, 8)
4. Cilat ishin pengesat kryesore për pranimin ndërkombëtar të RM-së? (dok. 10, 11, 12)
5. Pse udhëheqësit maqedonas pranuan pranim në KB me referencën IRJM?



Përpuno logo dhe program të shkurtër të një partie të imagjinuar për pjesëmarrjen në zgjedhjet e vitit 1990 në Maqedoni?

# MARRËDHËNIET NDËRETNIKE

Me Kushtetutën e vitit 1991 në Maqedoni u verifikuan: sovraniteti, pavarësia, integriteti tokësor, rregullimi demokratik dhe shteti unitar. Me kushtetutën u verifikua se sovraniteti buron nga qytetarët dhe u takon qytetarëve.

Me të, pjesëtarëve të kombësive u garantohez zhvillimi i identitetit të vet dhe veçorive nacionale. Gjithashtu garantohej mbrojtja e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar.

Megjithatë, partitë e kombësive dhe grupeve etnike ishin të pakënaqura nga Kushtetuta dhe kërkonin ndryshimin e tij. Veçanërisht me propozime të veta për ndryshime dilnin partitë e shqiptarëve në Maqedoni. Duke mos gjetur mirëkuptim për kërkasat e veta në institucionet e sistemit shqiptarët ndërmorën zgjidhje jashtë institucionale me qëllim që ta tërheqin vëmendjen. Në janar të vitit 1992 shqiptarët në Maqedoni organizuan referendum në të cilin u deklaruan për formim të "autonomisë politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni".

Gjithashtu turqit, vllehtë, serbët dhe romët në Maqedoni i formuan partitë e tyre dhe përpinqeshin për afirmim më të madh të të drejtave të tyre nacionale dhe kulturore.

1

## Regjistrimi i popullsisë në R. e Maqedonisë

Gjithsejt	1991	1994
Maqedonas	2 033 964	2 075 196
Shqiptarë	1 328 187	1 378 687
Turq	441 987	478 967
Romë	77 080	81 615
Vllez	52 103	47 408
Serbë	7 763	8 574
Të tjera	42 775	39 866
	84 068	40 079

2

## KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË E VITIT 1991

Neni 7

Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti cirilik i saj.

Në njësitë e vetëqeverisjes lokale në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e kombësive, në përdorim zyrtar, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i kombësise në mënyrë të verifikuar me ligj.

Neni 48

Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë që lirshëm ta shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e vet dhe veçoritë kombëtare.

Republika ua garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të kombësive.

Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe të tjera për të shprehur, kultivuar dhe zhvilluar identitetin e vet.

Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë në arsimim në gjuhën e vet në arsimimin fillor dhe të mesëm në mënyrë të verifikuar me ligj. Në shkollat në të cilat arsimimi zhvillohet në gjuhën e kombësive mësohet edhe gjuha maqedonase.

3

## Peticion i qytetarëve

Mbrëmë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, arriti një peticion nga qytetarë nga Tetova dhe fshatrat përreth. Në peticion mes tjerash thuhet se ata i kundërvihen referendumit për autonomi politike të Maqedonisë Perëndimore, që e përgatisin disa shovinistë shqiptarë, armiq të shtetit maqedonas, të cilët, duke e keqpërdorur demokracinë, duan të krijojnë "ditë të errëta për tërë Maqedoninë".

4

## Referendum i shqiptarëve në Maqedoni

Kryetari i kuvendit jolegitim për autonomi politike dhe territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni Guliaz Fejzullai theksoi se shpallja e referendumit është për shkak se në zgjedhjet e para demokratike shumëpartiake populli shqiptar nuk i fitoi të drejtat e tija legitime, sepse u pengua nga ana e pushtetit maqedonas. Prandaj më datën 27 të muajit të kaluar u formua kuvend në të cilin shqiptarëve iu mundësua lirshëm ta shprehin vullnetin e tyre.

*Nova Makedonija, 15.01.1992*



## Si zhvilloheshin marrëdhëniet ndëretnike në R. e Maqedonisë?

Në Maqedoni u krijuar klimë politike e ndarjes së bashkësive etnike në bazë politike. Gjatë kësaj votuesit çdoherë përcaktoheshin për opsonin politik i cili vinte nga bashkësia e tyre etnike.

Kërkesat e partive shqiptare për formimin e Universitetit u refuzuan nga Qeveria e R.M. Si rezultat i asaj në dhjetor të vitit 1994 u hap, fshehtazi, "universitet" në Reçicë të Vogël në afërsi të Tetovës.



A do të na i zgjedhin miqtë partitë politike



Maqedonas dhe shqiptarë para shitores së fshatit

### 5 Cilat janë kërkesat e PPD-së, PDP-së dhe fraksionit Thaçi – Xhaferi

- statusi i kombit për shqiptarët në Maqedoni dhe pozitë shtetformuese të tyre; rregullimi i Maqedonisë si shtet multinacional;
- federalizim të Maqedonisë; parlament dydhomësh; decentralizim;
- pakënaqësi nga pozita në të gjitha shkallët e shkollimit;
- formim të sistemit integral të shkollimit në gjuhën shqipe;
- universitet shqiptar në Tetovë; për këtë vit shkollarë është paralajmëruar mësim në 6 fakultete;
- pakënaqësi me përfaqësimin në administratën shtetërore, në përbërjen udhëheqëse të ARM-së, MPB-së, në diplomaci;
- hapësirë të pamjaftueshme kulturore, shkencore, intelektuale, informative;
- mospërfaqësimi i shqiptarëve në manifestimet kulturore dhe në festivalë;
- kërkesë për autonomi dhe lëshim të institucioneve të sistemit;
- marrëveshje historike politike ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve

### Çka kërkon Partia Demokratike e Serbëve

- kërkohet nga parlamenti, qeveria dhe kryetari i Republikës ndryshimi i kushtetutës së Maqedonisë që të zgjidhet pozita juridike e serbëve në Maqedoni dhe barazia e tyre me kombësitë tjera;
- ndryshimi i ligjeve zgjedhore që të mundësohet që serbët të kenë përfaqësuesin e tyre në parlament;
- formimi i komunave kishtare në 7 regjione të Maqedonisë dhe meshë në gjuhën shqipe dhe formim të Mitropolisë së Shkupit nga ana e Kishës Ortodokse Serbe;
- formim të teatrit dhe shoqërisë kulturore dhe arsimore në gjuhën serbe;
- formim të shkollave të mesme për fëmijët e serbëve;
- ndihmë qeveritare në botimin e gazetës javore;
- TV dhe radio programe në gjuhën serbe;
- leximore serbe dhe bibliotekë në Kumanovë dhe Shkup;
- formim të fondit për mbrojtje të përmendoreve të kulturës dhe të ngjarjeve historike të popullit serb në këto hapësira dhe posaçërisht mbrojtje të përmendores Zebrenjak.

### Çka do të inicioj Partia Demokratike e Turqve

- ndryshim të ligjeve zgjedhore që të mundësohet që nacionaliteti turk të ketë përfaqësuesin e vet në parlament;
- zgjidhje të problemeve ekzistuese në arsimimin e fëmijëve të nacionalitetit turk – fillor, të mesëm (rriti të numrit të paraleleve, përmirësim të kushteve në arsim në shkolla);
- zgjerim të kushteve kulturore, shkencore dhe informative për realizim të identitetit nacional të turqve në Maqedoni (zgjerim të radio dhe TV programit, ngritja e Birlikut në gazetë ditore...);
- përfaqësim të kuadrove të turqve në shërbimet shtetërore dhe në vende udhëheqëse në ndërmarrjet publike.

Puls, 04.11.1994

Në vitin 1997 për shkak të përdo-rimit të flamurit kombëtar shqiptar (i cili njëkohësisht është edhe flamur i R. së Shqipërisë) para ndërtesave të kuven-deve komunale në Gostivar dhe në Tetovë policia e Republikës së Maqedonisë intervenoi. Gjatë kësaj kishte edhe viktima njerëzore dhe arrestime të pjesëmarrësve në ngjarje.



U tërhoqën flamujt para komunës në Gostivar



Policia përballë masës së tubuar në Gostivar

## 6

### Ngjarjet e Gostivarit

Zoran Verushevski, zëdhënës i MPB-së: MPB e Republikës së Maqedonisë dje në orët e mëngjesit ndërmori aktivitete për zbritjen e flamujve të vendosur në mënyrë jashtëligjore para Këshillave të komunave të Gostivarit dhe Tetovës. Vet akti i zbritjes së flamujve kaloi pa incidente të mëdha. Në mëngjes rreth orës 8, një grup më i madh i qytetarëve para Këshillit të komunës së Gostivarit manifestoi agresivitet ndaj pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me ç'rast tre policë morën lëndime të rënda.

PPD-ja e dënon si të palogjikshëm dhe provokues veprimin dhe hyrjen e organeve policore në selitë e komunave Tetovë dhe Gostivar dhe e dënon sjelljen vandale që ajo e manifestoi me rastin e zbritjes së flamujve në këta dy komuna.

*Nova Makedonija, 10.07.1997*

## 7

### Ambasada a SHBA-s me rastin e ngjarjeve të Gostivarit

Ambasada e SHBA-s shpreh keqardhje të thellë për shkak të viktimate dhe të lënduarve të cilët ishin rezultat i ngjarjeve të Gostivarit. E shfrytëzojmë këtë mundësi ta përsërisim deklaratën e zëdhënësit të Stejt Departamentit nga 09 mars 1997, në të cilën thuhet se SHBA fuqimish e përkrahin integritetin tokësor dhe zhvillimin demokratik të Ish Republiës Jugosllave të Maqedonisë që paraqesin elemente themelore të stabilitetit në regjion. I thërrasim të gjithë qytetarët dhe partitë politike të punojnë brenda strukturave ekzistuese juridike dhe politike dhe t'i zgjidhin çështjet me interes nëpërmjet mjeteve të qeta dhe demokratike.

*Puls, 11 korrik 1997*

## 8

### BASHKËFSHATARË

...Ramadani thotë se në këtë anë të gjithë janë kurbetçinj, të gjithë kanë qenë nëpër botë, kanë marrë shprehi për sjellje kulturore, kështu që primitivizmi dhe provokimet nuk janë veti të këtyre njerëzve. Përkundrazi kur shohim fjalime të ashpra në parlament, thjesht turpërohem nga niveli i disa diskutimeve dhe nga kultura e deputetëve të caktuar. Duhet të ndalen ndarjet dhe tregimi me gisht, ndarja në **ata** dhe **ne**. Ajo nuk shpie askund, vetëm i acaron marrëdhënet dhe i mundon njerëzit e thjeshtë, të cilët kanë një kupë me probleme të përditshme. Tani për shembull për ne në Kamjan (Tetovë) një problem i madh është nafta përmakinan bujqësore.

...Stojanovski thotë se demokracia dhe partitë shumë i acaruan marrëdhënet ndërnacionale, megjithatë sërisht, gjë tani së paku në Sëllarcën e Poshtme (Tetovë) dhe në fshatrat përreth nuk ka pasur konflikte ndëretnike. Fshatrat jetojnë të ndarë, ndërsa e ndarë zhvillohet edhe jeta e maqedonasve edhe jeta e shqiptarëve.

...Arifi dhe Zilali thonë se duhet të vazhdojmë të shkojmë në dasma, gjëzime, ashtu siç shkonim, patjetër të mbahen marrëdhënet miqësore. Besoj, thotë Arifi se miqtë nuk i zgjedhin partitë politike, miqtë i zgjedhim vetë dhe vetë duhet të vendosim me cilin dhe si do të jetojmë.

...Siç thonë maqedonasit në Çellopek, banorët nga pakica shqiptare së pari duhet të kuptojnë se jetojnë në shtetin e Maqedonisë dhe se gjuhë zyrtare është maqedonishtja, ndërsa më pas edhe atë se shteti është edhe i tyre, edhe pse nuk votuan në referendum, nuk e votuan kushtetutën dhe nuk dolën në regjistrimin e popullsisë. Ajo, siç na thanë ata, në masë më të madhe i ftohi marrëdhënet dhe solli gjer te situata e tanishme mjaft e tensionuar në Maqedoninë Perëndimore.

*Nova Makedonija, 03.05.1992*

## Një Isamid dhe një Vasko

Pesëmbëdhjetë pyetje për njërin, të njëjtat edhe për tjetrin. Përgjigjet e ndryshme, por të mbushura me jetë dhe thjeshtësi. Ky tekstoparitet kurs të shkurtër për bashkëjetësë i liruar nga politikat e mëdha dhe Politikanët e Mëdhenj. Fjalën kryesore e kanë një Isamid dhe një Vasko. Ata janë anonimë të tërësishëm, nuk njihen mes veti, ndërsa intervistat janë bërë në hapësirë dhe kohë të ndryshme.

### - A ka maqedonas në shoqërinë tuaj?

*Isamidi:* Jo momentalisht jam në Tetovë dhe ndjej një ndarje. Shqiptarët janë të ndarë nga maqedonasit dhe nuk ka këmbim të mendimeve.

### - A ka në shoqërinë tuaj shqiptarë?

*Vasko:* Në shoqërinë time ka vetëm një shqiptar. Në fakt ai është shoku im nga fëmijëria, quhet Iso dhe ne nuk kemi tabu tema.

### - Si do të reagonit nëse nesër vajza juaj do të martohet me maqedonas?

*Isamidi:* Fëmijët e mi do të kenë të drejta të pakufizuara, por do të janë të edukuar ashtu që të mos përzihet kombi. Unë do të doja që të ngelen shqiptarë edhe nipërit e mi, por çdoherë t'i respektojnë të tjerët dhe t'i duan fqinjët e tyre. Megjithatë, në dashuri nuk mund të përzihemi, sepse edhe unë po të isha i dashuruar në maqedonase, babai im do të ishte i pafuqishëm të bëjë çfarëdo qoftë kundër dashurisë sonë.

### - Si do te reagonit nëse nesër vajza juaj do të martoget me shqiptar?

*Vasko:* Si do të reagoja? Nuk do të kisha asgjë kudër, por fëmijët e mi do të janë të edukuar të mendojnë si duhet. Nëpërmjet atij edukimi ata do të mund vetë të vlerësojnë a duhet diçka të ndodh apo jo. Përzierja e religjioneve sjell deri te komplikimi i marrëdhënieve në familje...

### - A shkoni në vizitë të fqinjëve tuaj maqedonas gjatë pashkëve?

*Isamidi:* Jo. Ua uroj të gjithë maqedonasve që i njoh kur i takoj në rrugë, në mëhallë. Bile njëherë ua urova disa maqedonasve në tren, përderisa udhëtonim...

### - A shkoni në vizitë të shqiptarëve gjatë kohës së ramazanit ose bajramit?

*Vasko:* Po, shkoj ta vizitoj shokun tim Ison gjatë këtyre festave. Shkoj nga respekti, ashtu siç vinë ai te unë gjatë pashkëve.

### - Çka mendon për krishterimin?

*Isamidi:* Religjioni ka vlera universale. Në çdo popull ka të mirë dhe të këqij. Sistemin e ligjeve religioze njerëzit e këqij nuk e respektojnë dhe kjo nuk është mirë. Përndryshe, islami dhe krishterimi kanë shumë gjëra të ngjashme.

Çka mendon për islamin?

*Vasko:* Çdo religjion ka anët e veta të mira dhe të këqija. Nuk di dhe nuk dua të përgjigjem në këtë pyetje më shumë se kjo.

### - Çka ju nervozon tek maqedonasit?

*Isamidi:* Si komb asgjë, por si pushtet i cili nuk din dhe nuk mund t'i zgjidh problemet... e, ata më nervozojnë. Më nervozojnë edhe media të caktuara maqedonase të cilat nëpërmjet disa bolshevikëve më krijojnë nervozë nationale.

### - Çka ju nervozon te shqiptarët?

*Vasko:* Ka ca gjëra në të cilat e taprojnë. Para së gjithash politike. A e dini çka, nëse duhet të ngelet ndonjë bashkëjetësë, patjetër të ketë disa kufi të sjelljes së mirë, deri ku shkohet dhe pse shkohet. Më pengon edhe ajo se kur takohesh me ndonjë shqiptar, menjëherë shikohesh politikisht. Edhe ai ti, edhe ti atë.

### - Si do ta kishe definuar bashkëjetësën?

*Isamidi:* A dëshiron malazezce? Përderisa të ruaj ti, do ta ruaj edhe veten nga ti.

*Vasko:* Të gjithë njerëzit në një shtet të kenë të drejta të njëjtë. Në këtë moment të gjitha nacionalitetet në Maqedoni i kanë të drejtat e nevojshtme si në të gjitha vendet demokratike botërore.

Isamidi dhe Vasko do të njoftohen nëpërmjet faqeve të kësaj gazete. Do të mund të shohin sa janë të afërt e sa janë të largët. Pyetem, a do të dëshirojnë ndonjëherë të shihen, të bisedojnë, të bëhen miq, të ndihmohen në rast nevoje? Nëse e bëjnë atë ky "kurs i shkurtër për bashkëjetësë" do të ketë efekt. Në të kundërtën çdo gjë do të ngelet me të vjetrën! Çka mendoni, cilin variant do ta zgjedhin?

Denes, 09.04.1998

- 1. Pse shqiptarët e Maqedonisë e organizuan referendum e tyre?
- 2. Si u manifestuan ndaj marrëdhënieve ndëretnike ngjarjet e Gostivarit?
- 3. Çka është e përbashkët në kërkesat e partive të nacionaliteteve? (dok. 7)
- 4. Si u manifestuan ngjarjet politike ndaj jetës së përditshme? (dok. 8 dhe 9)

Bëj intervistë me prindërit e tu me temën: Marrëdhëniet ndëretnike para dhe pas vitit 1990. Theksoi ngjashmëritë dhe dallimet.



# TRANZICIONI

## PRIVATIZIMI

Nga pavarësimi i Republikës së Maqedonisë, procesi i privatizimit u zhvillua sipas të ashtuquajturit "Ligji për Kapital Shoqëror" i sjellë në vitin 1989 dhe i rishikuar në vitin 1990. Në pajtueshmëri me këtë ligj është sjellë edhe "Ligji për shitje të banesave shoqërore" nga viti 1990. Me kushtetutën e re të vitit 1991 shteti garantoj liri të tregut dhe pozitë të barabartë juridike të të gjitha subjekteve në treg (neni 55 nga kushtetuta).

Prona e shtetit u transformua në bazë zë dispozitave nga ligji për privatizim dhe procedurës për shndërrim të pronës shoqërore në forma tjera të pronës, i cili u soll në fillim të vitit 1991 dhe u rishikua në tre raste. Veçanërisht i rëndësishëm është ligji i sjellë në vitin 1996.

Sidoqoftë privatizimi nuk i përbushi shpresat dhe nuk solli deri te rritja e të ardhurave në buxhet mbi bazën e shitjes së kapitalit.

Nga të gjitha ndryshimet e ndodhura me privatizimin e Republikës së Maqedonisë u shkaktua një stuhi e lëshimeve nga puna të të punësuarve nga ndërmarrjet e atëhershme shoqërore. Karakteristikë e kësaj periudhe është edhe shitja

**Pak jeni vonuar! Mbetën vetëm dy-tre ndërmarrje që nuk ua dhamë grekëve!**



Forum, 02.06.2000

## 1 Ligji për transformim të ndërmarrjeve me pronë shtetërore (1993)

### Neni 1

Transformimi i ndërmarrjes me kapital shoqëror... kryhet me organizimin e ndërmarrjes në shoqëria aksionare ose në shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me kapital në pronë private, respektivisht me pronar të përcaktuar... Transformimi kryhet edhe me shitje të kapitalit shoqëror ose të të gjitha mjeteve të ndërmarrjes...

### Neni 3

Personat dhe subjektet juridike... nuk mund të fitojnë të drejtë pronësore ndaj pasurive natyrore të Republikës së Maqedonisë, botës bimore dhe shtazore, të mirave në përdorim të përgjithshëm, si edhe të mjeteve dhe objekteve me rëndësi të veçantë kulturore dhe historike...

## 2 Shitia e banesave shtetërore

...qëllimi i ndryshimit të ligjit është lirimi i shtetit nga një pjesë e madhe e borxhit ndaj kursyesve të devizave...

...Sipas vlerësimeve të cilat janë bërë rreth vlerës së banesave të cilat do të shiten, për banesë prej 55 metrave katrorë, e vjetër 20 vjet dhe me amortizim prej 30%, duhet të paguhen 23.587 DM. Ose banesa e re me sipërfaqe të njëjtë në zonën e dytë do të kushtojë 67.000 DM.

...deri në fund të gushtit të këtij viti, gjithsej do janë shitur rreth 12.500 banesa shoqërore, që do të thotë se për t'u shitur ngelen rreth 48.000 banesa ose rreth 80%. Nëse merret sipërfaqja mesatare prej 50 deri në 60 metra katrorë për banesë del se vlera e fondit të banesave shoqërore në Maqedoni vlen rreth 2 miliardë marka gjermane.

Vëçer, 7 tetor 1992

## 3 PRIVATIZIMI SOLLI SHUMË PAK PARA TË GATSHME

Deri në fund të vitit 1999, në procesin e privatizimit u inkuadruan 1488 ndërmarrje me kapital të përgjithshëm prej 4.1 miliard DM me afér 215.000 punëtorë. Procesi i privatizimit ka përfunduar pothuajse në më shumë se gjysma nga numri i ndërmarrjeve, kurse për 700 ndërmarrjet e mbeturë procesi i privatizimit do të duhet të përfundojë deri në fund të këtij viti. Nga gjithsej 1700 ndërmarrje, vetëm 10 prej tyre ende nuk kanë të caktuar pronarët. Nga vetë punëtorët u blenë 384 ndërmarrje, kurse investitorët e huaj investuan në 156 ndërmarrje. Deri tanë shteti ka përfituar 444 milionë DM, prej të cilave vetëm 65 milionë DM janë paguar me para të gatshme. Gjatë tre muajve të parë privatizimi kishte përfunduar në 51 ndërmarrje, kurse 12 ndërmarrje tjera shitën vetëm një pjesë të aksioneve. Gjatë vitit 1999, privatizimi i solli shtetit 91 milion DM, kurse vetëm në çerekun e parë të vitit 2000 shteti fitoi 72 milion DM dhe deri në fund të vitit 2000 pritet që shteti të fitojë edhe 125 milionë DM, prej të cilëve 10% do të janë para të gatshme.

FAKTI, Nr. 699, 29 Korrik 2000

## 4 Edhe krahas vlerësimeve të para se privatizimi do të mbaroj deri në fund të vitit 200, kjo nuk ndodhi. Rastet dhe kompanitë më problematike dhe më të rënda ende nuk janë privatizuar... Agjencja për privatizim është optimiste se procesi do të mbaroj me sukses. Nuk kemi komente për ata privatizime të cilat u përcaktuan si skandalozë...

"Kapital", 11.01.2001



## Cilat janë pasojet nga tranzicioni në shoqëri?

e objekteve të rëndësishme ekonomike me anë të marrëveshjes së drejtpërdrejtë ndërmjet qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe ndërmarrjeve nga shtetet e jashtme.

Procesi i tranzicionit solli shumë afera financiare mes të cilave edhe falimentimi i bankave, kursimoreve dhe ndërmarrjeve, me pasoja afatgjata ndaj popullsisë së Maqedonisë. Më e madhja nga ato ishte afera TAT e vitit 1997 kur pa depozitat e tyre kursyese ngelën 23.000 njerëz me depozite në vlerë prej 60.000.000 euro.

### DENACIONALIZIMI

Në mesin e ligjeve më të rëndësishme nga fusha ekonomike ishte Ligji për Denacionalizim i sjellë në vitin 1998. Me të parashihej kthimi i pronave të nacionalizuara pas vitit 1944. Qëllim i denacionalizimit ishte prona shoqërore, respektivisht kthimi i të njëjtët në pronësi të mëparshme. Ky proces nuk ka përfunduar ende.

**Pa brengë, për depozitet e juaja devizore garanton shteti...?**



Osten, 27.04.1991

5

Qeveria e mësuar nga shembulli negativ në shitjen e rafinerisë së Shkupit OKTA të para dy viteve (ai transaksion u bë në mënyrë absolutisht diskrete dhe elementet më të rëndësishme të marrëveshjes ende janë të panjohura) i cili u trajtua si fshehtësi e lartë, u vendos për transparencë në rastin me Telekomunikacionin e Maqedonisë. Mediat fjalë për fjale bombardon me të gjitha llojet e informatave dhe shumat e parave që janë dhënë në valutë të huaj dhe pa teprime u bë ashtu që t'i rrotullohet në kokë maqedonasit ... Mesazhi gjér te publiku ishte i qartë dhe i kuptueshëm: "Ne të gjithë do të punojmë me Telekomin në një mënyrë jashtëzakonisht transparente, respektivisht në mënyrë më të pastër të mundur".

*Makedonsko vreme, janar 2001*

6

### Ligji për denacionalizim

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet mënyra, kushtet dhe procedura për kthimin në pronësi të pronës, respektivisht dhënie të kompensimit për individë shtetas të Republikës së Maqedonisë për pronë të marrë në dobi të shtetit.

Neni 4

Dispozitat nga ky ligj zbatohen edhe kur prona është marrë me konfiskim të bërë për vepra të dënueshme deri në hyrje në fuqi të Kodit Penal (Fleta Zyrtare e RSFJ-së, nr. 13/51), përvèç për vepra të krimeve të luftës. Dispozita nga paragrafi 1 i këtij nenit nuk zbatohet për dënim të veprave penale që për pasojë kanë pasur:

- vdekje, lëndim të rëndë trupor të një apo më tepër personave ose dhunë tjetër ndaj personave;
- rrënim apo dëmtim të pronës së huaj me masë të madhe, eksplodim apo akt tjetër të terrorizmit dhe
- vjedhje, plaçkitje, grabitje apo grabitje të dhunshme.

*Gazeta Zyrtare e R. së Maqedonisë, nr. 20/98 nga 29.04.1998*

7

Ligji për transformim të kapitalit shoqëror nga viti 1993 e paralajmëroi denacionalizimin. Por, krahës përcaktimit të këtillë të shtetit, ekziston rezistenca të fuqishme te disa faktorë politikë dhe individë. Prandaj qytetarët e formuan Shoqatën për Mbrojtje të Interesave të Pronarëve të Pronave të Mara nëpërmjet së cilës kërkon sjellje më të shpejtë të ligjit për denacionalizim. Ligji u soll në vitin 1998, por ai nuk ishte i pranueshëm për pronarët e dikurshëm. Me ligjin e vitit 1999, qytetarët sërisht morën pjesë të madhe të pronës së marrë dhe dëmshpërblim me anë të obliguesve dhe aksioneve. Aktvendimet e para për kthim të pronesisë iu dhanë pronarëve më 05.09.2000...

*Interview me Vasiliki Vikentjeviq, Kryetar i Shoqatës për Mbrojtje të Interesave të Pronave të Konfiskuara*

8

Më është marrë një pjesë e pronës (tokë) në vitin 1949. Në pronën time është ndërtuar objekt i kooperativës së fshatit. Pas sjelljes së ligjit parashtrova kërkesë deri te qeveria e R. së Maqedonisë dhe në vitin 1996 prona më u kthye mbi bazën e ligjit të sjellë për denacionalizim.


*Jusuf Murati nga fshati Odër, Tetovë*

Nërmarrje private Gjigant industrial



Osten, 18.11.1991

Nuk ka rrymë - Nuk ka lëndë të para - Nuk ka rrogë



Osten, 13.02.1991



Makedonsko vreme, korrik 2001



Start, 14.04.2000

9 Uraa kemi pluralizëm!



Osten, 16. 01.91

Papunësia

Viti 1990 – 156.000 të papunë.

Viti 2000 – 361.300 të papunë.

*Numri i të punësuarve zvogëlohet në:*

Industri	-44,5%
----------	--------

Bujqësi	-48,0%
---------	--------

Ndërtimitari	-47,0%
--------------	--------

Transport dhe lidhje	-20,0%
----------------------	--------

Tregti	-77,0%
--------	--------

Turizëm dhe hoteleri	-48,0%
----------------------	--------

Vjetari Statistikor i Republikës së Maqedonisë, 1991-2001

10

Kohë varfërie

...Kishte greva. Nëntëqind punëtorë të SHPK Frigoriferët për amviseri të holdingut nga Manastiri FR Gjinko hyrën në grevë të përgjithshme. Kërkesat që i parashtruan nuk janë të pazakonshme: dorëheqja e drejtorit dhe ekspit udhëheqës, si edhe pagesa e 20 rogave të vonuara, pagesa e të gjitha kontributeve dhe shtesave që ndërmarrja i keqpërdor nga viti 1994 e këndej... Dikur janë prodhuar 250 000 frigoriferë në vit, ndërsa tani vetëm 2000. Janë humbur tregjet në Itali, Francë, Gjermani, Austri, Amerikë.

Javorja Denes, nr. 30, 7 maj 1998

11

Probleme me banimin

Kam 36 vjet. Me gruan time u martuam para 10 viteve, në vitin 1997. Në atë kohë ajo ende studionte, ndërsa unë punoja në Ministrinë e Punëve të Brendshme si teknik për mirëmbajtjen e pajisjeve, ku punoj edhe sot. Pas dasmës jetuam me prindërit e mi, sepse nuk kishim kushte të jetojmë në banesë me qira ose në banesën tonë, për të cilën në atë kohë nuk mendonim, por shumë e dëshironim. Mendonim se me kalimin e kohës kushtet për jetesë do të përmirësohen, bashkëshortja do të punësohet, do të marrim kredi banesore dhe do të blejmë banesë. Gruaja ime e kreua fakultetin, por punë nuk mundte të gjejë disa vite. Në ndërkohë na lindën dy fëmijë të bukur, Bojana (7 vjeçë) dhe Aleksandri (3 vjeç). Ne ende jetojmë në banesë prej 55 metrave katrorë bashkë me prindërit e mi, motrën time, dhe fëmijët e mi. Bashkëshortja ime u punësua, por ende me të ardhurat tona nuk kemi aftësi kredimarëse që të marrim kredi banesore dhe ta zgjidhim këtë problem jetësor.

Kujtime të Dime Daskalovskit

12

Të mërguarit

Të ballafaquar me gjendjen pa perspektivë, papunësinë, varfërinë, mbi këta edhe gjendja me luftë, me jetën në shtetin i cili nuk garanton siguri, shumë njerëz të rinj shpëtimin e vet e kërkojnë në ndonjërin nga vendet e premtuara.

Shpalljet në media ofrojnë mundësi të shpejtë dhe të lehtë për të ikur. Më së shpeshti, më të kërkuar janë vizat emigruese për në Kanadë dhe për në Zelandën e Re. Interesimi nuk është i vogël edhe për në SHBA, Itali, Australi, Gjermani, Zvicër dhe të tjera. Mundësitë janë veçanërisht të mëdha për ata të cilët kanë mësuar ndonjë zeje ose me profesion janë inxhinierë, ekspertë softuerik, teknikë, punëtorë mjekësorë dhe të ngashme. Lista është më e gjatë, por profesionet e përmendura kanë përparësi më të madhe dhe, kuptohet, njohja e gjuhëve të huaja.

Amza e të mërguarve të R.M.

Në vitet e tranzicionit shumë njerëz u pasuruan në mënyrë të shpejtë dhe për shumëkënd të panjohur. Njerëzit e tillë kishin nevojë që paratë e tyre të fituara në mënyrë jolegale t'i arsyetojnë si të fituara legalisht. Kështu u menduan fjalët Larje Parash, respektivisht paratë e fituara në mënyrë të ndytë të kalojnë nëpërmjet ndonjë veprimitarie vetëm që të ndryshohet prejardhja e tyre e mëparshme.



Në kohën kur u kalua në sistemin shumë-partiak dhe kur qytetarët ishin të lirë të zgjedhin për cilin do të votojnë ndodhën shumë parregullsi në vendvotime. Rregullat e papërshtatshme ligjore rreth votimit dhe mosrespektimi i të njëjtave ishin arsy që të zbatohen masa jodemokratike dhe metoda përfitimin e votave ose pengimin e votimit normal si edhe zhdukjen joligjore të rezultateve të vlefshme.



**13** Krahas të dhënavë që janë indikator bindës për gjendjen e pavolitshme ekonomike në vend, vazhdimesh kumtohen të dhënat e njëjtë përrrogëni mesatare, e ndonjëherë bile edhe me një përqindje të rritjes. Ajo që në këtë plan është paradoksale, është se mesatarja në veprimtaritë ekonomike mbetet e njëjtë, ndërsa rritje shënon rruga në veprimtaritë joekonomike. Marrë në tërësi, sipas të dhënavë përrrogat mesatare, standardi është i mirë. Kryesorja për të dhënat statistikore është të tregohet se megjithatë ka standard. Por realiteti ndryshon nga numrat, ngase, sipas logjikës së kësaj statistike, del se nëse dikush ha mish e dikush lakra, mesatarisht të gjithë hanë sarma! Në rastin tonë, ndërkaq, del se sarma hanë edhe ata të cilët me muaj të téré s'kanë marrë rruga... Sipas kësaj del se sa më shumë që rritet numri i të papunëve, aq më e lartë është rruga mesatare.

Jeta, 10 tetor 1997, fq.14

**14** Kur flasim përkundërvajtjet e të miturve, atëherë mendojmë në një sërë sjelljesh te të rintjtë që i takojnë moshës prej 14-18 vjet, duke filluar nga sjellja e paedukuar, e pandershme, e deri te kryerja e veprave më të rënda penale. Një pjesë e sjelljeve kundërvajtëse (ikja nga shtëpia, ikja nga shkolla, sjellja e pandershme etj) nuk mund të kualifikohen me përpikëri, edhe pse me siguri mund të konstatojmë se janë në rritje. Delikuencia e të miturve në shtetin tonë tregon se karakteristika të kriminalitetit më të rëndë me pjesëmarrje gjithnjë e më të madhe të veprave të rënda penale, me organizim më të madh, pjesëmarrje më të madhe të përsëritësve dhe të personave më të rinj. Numri i veprave kriminale sipas viteve është: 1986-1738, 1987, 1988-1763, 1989-1762, 1990-1809, 1991-2211, 1992-2668, 1993-2616, 1994-2289 dhe 1995-2314. Nga kjo shihet se sipas evidencës në periudhën që e quajmë tranzicion, veprat penale shënojnë rritje.

Javorja Denes, nr. 22, 12.03.1998

#### |EPITAF I TRANZICIONIT

(Kur t'i vijë radha)

- Kur dikush di dhe e di që di – mëso nga ai;
- Kur dikush di dhe nuk e di që di – vetëdijesoje;
- Kur dikush nuk di dhe e di që nuk di – mësoje;
- Kur dikush nuk di dhe e din që nuk di – largoju nga ai.

Studentski Zbor, 20.12.1995

- 1. Cilat ndryshime u bënë me procesin e privatizimit në Republikën e Maqedonisë?
- 2. Pse shitja e ndërmarrjeve shoqërore nuk i plotësoi shpresat?
- 3. Si u manifestua procesi i tranzacionit ndaj numrit të vendeve të punës në vend?
- 4. Ku e shihnin rrugëdaljen personat e papunë?
- 5. Si manifestoheshin problemet e tranzacionit ndaj të rinjve?

Bëj intervistë me person i cili e ka humbur vendin e tij të punës në kohën e tranzacionit. Mëso për arsyet dhe pasojat nga ajo, si edhe për shpresat dhe zhgënjimet e atij personi

# JETA E PËRDITSHME

## JETA FAMILJARE

Ndryshimet politike të cilat ndodhen pas vitit 1990 u ndikuan edhe në planin shoqëror, e posaçërisht në jetën e përditshme të njerezve në Maqedoni.

Me kushtetutën e re të vitit 1991 u sollën edhe ligjet e reja përmartesë dhe familje në Republikën e Maqedonisë. Njëkohësisht me kushtetutën u mundësua edhe ushtrim më i lehtë i religjionit. Në atë drejtim, dhe në lidhje të drejtpërdrejtë me jetën familjare u bënë edhe hulumtime të rëndësishme shkencore e statistikore të cilat treguan keqësim të përgjithshëm të kushteve të jetës në Maqedoni. Periudha e përmendur karakterizohet me mbyllje të një numri të madh të kapaciteteve prodhuase të cilët shkaktuan rritje të papunësisë dhe probleme ekzistenciale. Kjo gjendje drejtpërdrejtë ndikoi ndaj lidhjes së martesave si edhe përmirësimi i jetës së Maqedoni në fillim të viteve të 90-ta të shek. XX ishte arsyet përritjen e numrit të shkurorëzimeve.

Të ndikuar nga gjendja e keqësuar ekonomike dhe sociale një numër i madh i qytetarëve vendosën të emigrojnë. Kjo dukuri nuk solli deri te përmirësimi i gjendjes socio-ekonomike në vend.

1

### Family low

Neni 2

Familja është bashkësi jetësore e prindërve dhe fëmijëve dhe farefisit tjeter, nëse jetojnë në amvisëri të përbashkët.

Familja krijohet me lindjen e fëmijëve edhe me adoptim.

Neni 3

Marrëdhëniet në familje mbështeten mbi barazinë, respektin e ndërsjellë, ndihmën e ndërsjellë dhe përbajtje dhe mbrojtje të interesave të fëmijëve të mitur.

Neni 6

Martesa është bashkësi e vërtetuar me ligj e burrit dhe gruas në të cilën realizohen interesat e partnerëve martesorë, familjes dhe shoqërisë.

Marrëdhëniet ndërmjet partnerëve martesorë mbështeten mbi vendimin e lirë të burrit dhe gruas të lidhin martesë, mbi barazinë e tyre, respektin dhe ndihmën e ndërsjellë.

*Gazeta zyrtare e R. së Maqedonisë, 22.12.1992*

2

### Kurorëzime dhe shkurorëzime

Vjetari statistikor për vitin  
1998, Shkup

	Kurorëzime	Shkurorëzime
1994	15736	612
1995	15823	710
1996	14089	705
1997	14072	1021
1998	13993	1027

3

### Anketë përvaférinë


Në një anketë përvaférinë është theksuar se: 60% janë ata të cilët thonë se luftojnë me vaférinë, 23% kanë ekzistencë nën minimalen. Për këtë:

- 23,1% nuk kanë para të blejnë ushqim;
- 38,4% nuk mund të sigurojnë veshmbathje;
- 31,7% nuk mund të sigurojnë sende të shtrenjta;
- 5,8% mund të blejnë sende të shtrenjta
- 1% mund të blejnë çdo gjë

*D. Velkoviq, Rënim i tranzicionit, Shkup 2001*

### 4 Pajisje shtëpiake dhe automobila më 1996

Enti statistikor, Vjetari statistikor, 1997





## Në cilën mënyrë ndryshimet në shoqëri ndikojnë në jetën e përditshme?

### KULTURA MASIVE

Kultura masive në thelb përbëhet nga më shumë elemente, të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në zhvillimin kulturor të seçilit shtet. Në këtë periudhë është vërejtur ngecje e prodhimit të filmave dhe shfaqjeve kinematografike. Në të njëjtën kohë institucionet kulturore si galeritë, muzetë, kinematë, teatrot, bibliotekat, si edhe ngjarjet tradicionale kulturore, janë lënë në prag të mbijetesës për shkak të mjeteve të zvogëluara financiare. Është i konsiderueshëm edhe numri i institucioneve që janë mbyllur.

Mënyra e të jetuarit në Maqedoni në këtë drejtim është ndryshuar edhe me përdorimin e mediave masive, atyre të shtypura dhe elektronike, si edhe teknologjia kompjuterike gjithnjë e më aktive, telefonia mobile, aparateve për amvisëri etj.

Fuqia e zvogëluar ekonomike e familjes ndikoi ndaj zbavitjes dhe jetës së natës te popullata e re. Në këtë drejtim u shfaq edhe situatë paradoksale: papunësia e madhe, kafenetë e plota.

5

	Kinema	Filma me metrazh të shkurtër	Filma me metrazh të gjatë
1991	51	6	1
1992	43	3	/
1993	40	4	3
1994	39	4	/
1995	38	3	2
1996	40	3	/
1997	38	/	/
1998	36	/	/

Vjetari statistikor për vitin 1998, Shkup

6 Në vitet e 90-ta ishin aktuale disa kafene ku mblidheshim ne të rinjtë. Pas orëve të kaluara në shkollë rregullisht shkonim në "Tropikana" (përballë King Burgerit) për një pije. Atje çdoherë merreshim vesh ku do të shkonim atë natë. Zakonisht shkonim në "Central" në Bunjakovec, "Boni" (përballë ambasadës greke) ose në diskotekën MNT. Çmimet ishin të përshtatshme për ne prandaj mund t'i lejonim vetes që të dalim çdo natë ose çdo të dytën natë. Me muzikën e UB40, Duran Duran, Simply Red, Lisa Stensfiled etj, ata vite ngelën thellë në kujtesën time.

Kujtimet e Daniela Vesiqit, 17.05.2007-11-05

7 Kur isha i ri, si 18 vjeçar në vitin 1995 kisha dëshirë të ngelem në qytet deri natën vonë, megjithatë ajo nuk ishte e mundur sepse nuk kishte transport të kthehem i në fshat në orët e vona. Në fshat ishte e pamundur të organizohen zbavitje, sepse vajzat nuk dilnin, sepse kjo ishte e turpshme. Nëpër kafenetë nëpër fshatra dilnin vetëm meshkujt. Ata që kishin automobila dhe ata që ishin nga qyteti, e të cilët ishin në numër të vogël mundeshin të zbaviten deri vonë, por edhe ata nuk kishin shoqëri të madhe. Paratë e xhepit i kishim të pakta prandaj nuk mundeshim t'i vizitojmë lokalet më të njobura. Çmimet e tyre ishin edhe katër herë më të larta se të lokaleve tjera. Megjithatë jo gjithherë duhej të kihet para për t'u ndjerë si pjesë e jetës së natës. E mjaftueshme ishte edhe ecja nëpër shëtitore.


Kujtimet e Besnik Eminit, 2007, Shkup

8

Akti i lëshimit në përdorim i centralit të ri telefonik i takoi kryeministrit Lubço Georgievski, i cili me këtë rast tha se me lëshimin e 100.000 numrave të rindë të telefonave celular, territori i vendit do të mbulohet pothuajse 90%. ... prej nesër Telekom i Maqedonisë do të zbret çmimin për parapagimin e telefonave celular prej 250 marka në 100 marka, dhe jam i mendimit se një vendim i këtillë do të mundësojë që çdo qytetar i Maqedonisë të jetë parapagues potencial i telefonit celular, tha për fund kryeministri.

Gjithashtu dje u bë nënshkrimi i Marrëveshjes për implementimin e Internet Protokollit të ri të rrjetit të optimizuar në Telekomin e Maqedonisë, bazuar në pajisjet e liderit botëror të këtij lloji-Cisco Systems.

FAKTI, Nr. 697, E enje, 27 Korrik 2000, fq. 5



Osten, 16. 01.91

## ARSIMI

Ligjet e posamiratuara mundësuan formim të shkollave të mesme private. Njëkohësisht u kryen edhe ndryshime të planeve dhe programeve mësimore për arsimin fillor dhe të mesëm.

Me ligjin për arsim të lartë nga viti 1995 në universitetin Shën Kirili dhe Metodi u vendos kuota për nacionalitetet. Me të parashihej regjistrimi i përqindjes së njëjtë të numrit të studentëve me numrin e përqindjes së popullatës përkatëse në Maqedoni. Ndryshimet e këtilla kontribuuan për përfaqësimin më të madh të nxënësve dhe studentëve nga të gjitha nacionalitetet.

Në vitin 1994 në Tetovë u themelua universitet, i cili ligjërisht nuk ishte pjesë e sistemit arsimor. Edhe krahas kësaj, në Universitet edukoheshin një numër i madh i studentëve shqiptarë në më shumë fakultete.

### Protesta studentore për participim më të ulët

Nënë dhe baba! Vendoseni shtëpinë në hipotekë dua të studioj



Pse në rrugë kur mundet në fakultet



Revista mujore "Imixh", 2000

## 9

### Dje dhe sot

Në erën komuniste, sistemi arsimor ishte krijuar që t'i shërbë politikës zyrtare dhe t'i përgatitë të rintjtë për jetë në sistemin një partiak. Të rintjtë i mësonin se opsione të vetme për jetë të mirë dhe të sigurt janë: "Tito" ose "Partia". Parulla për Titon kishte gjithkund në shkollë, siç janë: "Tito është i yni, ne jemi të Titos", "Edhe pas Titos – Tito" etj.

Tani çdo gjë është ndryshe. Politika u largua nga shkolla. Shkollat tani janë të plota me parulla të tjeterllojta kushtuar shkencëtarëve dhe veprimtarëve kulturorë, ndërsa fëmijët nuk detyrohen të simpatizojnë ndonjë parti politike ose ndonjë mendim politik. Ata janë të lirë të janë fëmijë.

*Interview me mësuesin Trajko Noveski, 2000*

## 10

### Përfaqësimi sipas paraleleve në gjuhën mësimore në arsimin fillor

	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Serbë
1995/96	69,5 %	28,0 %	2,2 %	0,3 %
1996/97	69,0 %	28,4 %	2,3 %	0,3 %
1997/98	68,5 %	29,0 %	2,3 %	0,2 %
1998/99	66,8 %	29,9 %	2,4 %	0,2 %
1999/00	65,9 %	30,4 %	2,5 %	0,3 %

## 11

### THEMELIMI DHE NDËRPRERJA E PUNËS SË INSTITUCIONIT TË LARTË ARSIMOR

Neni 33

Institucion shtetëror të arsimimit të lartë themelon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë

Neni 34

Institucion privat të arsimit të lartë mund të themelojë subjekti juridik dhe individi nga vendi dhe vendi i jashtëm.

Subjekt juridik dhe individ nga jashtë shtetit mund të themelojë institucion privat të arsimimit të lartë, nëse i plotëson kushtet e parapara me këtë ligj, mbi bazën e miratimit nga ana e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Institucion privat i arsimit të lartë mund të themelohet në kuadër të universitetit privat dhe jashtë tij, si institucion i pavarur i arsimit të lartë.

*Ligi për arsim të lartë, Gazeta zyrtare nga 03.08.2007*

## 12

### Religjioni si lëndë e veçantë mësimore: po ose jo

Mendimi i nxënësve për përfshirjen e religionit në mësim. Religjioni duhet të mësohet si:

- |  |        |
|--|--------|
| 1. Lëndë e detyrueshme në të gjitha shkollat | 6,14%  |
| 2. Fakultative – vullnetare                  | 57,02% |
| 3. Nëpërmjet lëndëve tjera mësimore          | 36,84% |

Mendimi i nxënësve për përhapje të religjionit dhe manifestimit të saj në marrëdhëni ndërnacionale. Me religion të përhapur marrëdhëni ndërmjet nacionaliteteve do të:

- |   |        |
|---|--------|
| 1. Përmirësohen                             | 5,26%  |
| 2. Keqësohen                                | 61,40% |
| 3. As do të përmirësohen as do të keqësohen | 13,16% |
| 4. Nuk e di                                 | 20,17% |

*Dr. Krste Angelovski, Arsimi dhe religjioni, Shkup, 1995*

Në vitin 1997 u mbajtën protesta masive të studentëve nga Akademia Pedagogjike në Shkup, të cilëve iu bashkëngjitën edhe nxënësit e shkollave të mesme maqedonase. Pjesëmarrësit në protesta reagonin ndaj vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në lidhje me ngritjen e Akademisë Pedagogjike në Fakultet Pedagogjik dhe përfshirjen e gjuhës shqipe në të njëtin.

Në vitin 2000 u soll ligji për hapjen e universiteteve private, me çka u hap mundësia që studentët të zgjedhin ndërmjet arsimimit shtetëror dhe privat. Në bazë të ligjit të përmendur u hapën disa fakultete dhe universitete private.



Protesta të nxënësve të shkollave të mesme dhe të studentëve kundër përfshirjes së arsimimit në gjuhën shqipe në Fakultetin Pedagogjik



Universiteti i Tetovës i rrënuar, 14.12.1996



Menduh Thaçi i thërrët shqiptarët të shpërndahen, 17.12.1994

## 13

**U themelua universitet shqiptar**  
Mbrëmë vonë në selinë e partisë PPD në Tetovë, në prezencë të kryetarëve të disa partive politike shqiptare, anëtarët e Këshillit për Themelim të Universitetit në Tetovë në gjuhën shqipe, disa deputetë shqiptarë, ministra shqiptarë, kryetarë e komunave të Tetovës, Gostivarit dhe Dibrës, Shoqatës së Grave Shqiptare, organizata humanitare El Hilal, PAD-Ruga islame, gazetarëve të TV ART-it dhe korrespondentit të Flakës, për shkak të situatës së tensionuar dhe mënjanimit të ekseseve të mundshme, d-r Fadil Sulejmani, kryetar i Klëshillit, e leksi aktin e themelimit të universitetit në gjuhën shqipe i cili përmban 12 nene në të cilat janë përfshirë të gjitha pikat juridike për funksionimin e një institucioni të lartë arsimorë për mësim dhe studim në gjuhën shqipe. Ky akt u përvendet me duartrokitje dhe urime të cilat i dhanë karakter solemn këtij takimi. Akti u nënshkrua nga të gjithë të pranishmit.

## 14

**Deklarata e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Universiteti në shqip nuk është në pajtueshmëri me kushtetutën**

Qeveria mori qëndrim se në kuadër të të drejtave të shqiptarëve të definuara në kushtetutë të gjenden forma që të u mundësohet arsimtarëve arsimim në gjuhën amtare të nacionaliteteve. Ministrat dhe zëvendësministrat shqiptarë distancohen nga qëndrimi i Këshillit të Qeverisë.

Flaka e Vëllazërimit, 13.12.1994

## 15

**Me buldozer kundër universitetit**

Në Reçicë bëhet rrënim i pjesëve “të egra” të universitetit. Janë arrestuar dr. Fadil Sulejmani, Milaim Fejziu dhe aktivistë tjerë. Subjektet politike dhe shoqatat shqiptare i dënojnë masat represive kundër universitetit shqiptar në Tetovë. Mbledhja ndërmjet përfaqësuesve politikë shqiptarë me kryetarin Gligorov – pa rezultate konkrete.

Flaka e Vëllazërimit, 15.12.1994

1. **Bëni krahasim ndërmjet numrit të kurorave të lidhura dhe shkurorëzimeve.**  
Përmendni arsyet për atë situatë.
2. **Bëni krahasime ndërmjet zbavitjes së të rinxve në fshat dhe në qytet, si edhe ndërmjet zbavitjes së të rinxve nga nacionalitetetë të ndryshme?**
3. **Cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet në sistemin arsimor para vitit 1991 dhe pas vitit 1991?**  
Përpunoni T-Tabelë.
4. **Sipas dokumenteve, vëreni kundërshtitë. Cili institucion është i autorizuar të themeloj institucion të arsimit të lartë? Ku dhe në prezencën e kujt është themeluar universiteti shqiptar? Për cilat arsyet merrnin pjesë personat dhe shoqatat e përmendura?**
5. **Pse studentët dhe nxënësit e shkollave të mesme dolën në masë në protesta në vitin 1997?**



Në bazë të fotografi bëni ese të shkurtër.

## PJESËMARRËSIT NË PROJEKT

Mire Mladenovski

*udhëheqës i ekipit*

Shkolla fillore "Tihomir Miloshevski" - Shkup

Todor Çepreganov

Instituti i Historisë Nacionale

Katerina Naumoska

Instituti i Historisë Nacionale

Isamedin Azizi

Instituti i Historisë Nacionale

Besnik Emini

Shkolla e mesme "Zdravko Cvetkovski" - Shkup

Valentina Stamenkoviç

Shkolla e mesme "D-r Pançe Karagjozov" - Shkup

Harun Rexhepi

Shkolla fillore "Migjeni" - Tetovë

Ljupka Hristova

Shkolla fillore "Joakim Krçoski" - Shkup

Kenan Iseni

Shkolla e mesme "D-r Pançe Karagjozov" - Shkup

Iljo Trajkovski

Gjimnazi "Josip Broz - Tito" - Manastir

Behar Mehmeti

Shkolla fillore "Kongresi i Manastirit" - Shkup



## REDAKTURA DHE DIZAJNI

Mire Mladenovski

## PËRKTHIMI DHE LEKTURIMI

Besnik Emini

SHTYPI

NIKO COMPANY - Shkup

*Ky projekt finanziarishët është përkrahur nga Instituti Amerikan i Paqës*

